



Nr 3430 Prot
Tiranë më 12.06. 2015

Nr 5385/1 Prot
Tiranë më 16.07. 2015

Nr 4496 Prot
Tiranë më 12.06. 2015

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMIT

“PËR IDENTIFIKIMIN DHE MBROJTJEN E FËMIJËVE NË SITUATË RRUGE”

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi hartohet ndërmjet palëve:

Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, e njohur më poshtë si “MMSR” ;

Ministrisë së Punëve të Brendshme, e njohur më poshtë si “MPB”;

dhe

Ministrisë së Arsimit dhe e Sporteve, e njohur më poshtë si “MAS”;

Duke synuar ndërmarrjen e përpjekjeve të përbashkëta institucionale parandaluese dhe mbrojtëse, si një garanci për zhvillimin dhe mirëqenien e fëmijëve në situatë rruge, të cilët janë ndër grupet më vulnerabël dhe që jetojnë në kushte të papranueshme fizike, sociale dhe psikologjike, duke u bërë subjekt i formave të ndryshme të dhunës, abuzimit dhe shfrytëzimit;

Duke synuar respektimin e parimeve të përmbajtura në dokumentat themelore, si: interesi më i lartë i fëmijës, barazia dhe mosdiskriminimit, parimi i së drejtës së jetës, zhvillimit dhe mirëqenies, mbrojtja nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi dhe përdorimi për punë, respekti për pikëpamjen e fëmijës, ruajtja e konfidencialitetit, parimi i pjesëmarrjes dhe mundësive të barabarta, i jetesës pa barriera dhe mjedisit të lirë, i rehabilitimit, parandalimit, integritit shoqëror dhe pjesëmarrjes në jetën e komunitetit;

Duke u bazuar në nevojën për ndërhyrje të qëndrueshme, ndër-sektoriale për adresimin e fenomenit të fëmijëve në situatë rruge, si dhe nevojën për vendosjen e praktikave të qëndrueshme parandaluese për informimin dhe edukimin e shoqërisë, familjes dhe në veçanti të fëmijës mbi këtë fenomen;

Duke iu referuar Planit të Veprimit për identifikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge të hartuar nëpërmjet konsultimeve të përbashkëta të palëve;

Në mbështetje të nenit 54 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; Ligjit Nr. 7850, datë 29.7.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; Ligjit Nr.9062, datë 08.05.2003, "Kodi i Familjes"; Ligjit Nr.7895, datë 27.01.1995, "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; Ligjit Nr.10347, datë 4.11.2010, "Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës"; Ligjit Nr. 9355, datë 10.03.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", i ndryshuar; Ligjit Nr.9749, datë 04.06.2007, "Për Policinë e Shtetit", i ndryshuar; Ligjit nr.69/2012, datë 21.06.2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë"; Vendimit Nr. 265, datë 12.04.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin dhe funksionimin e mekanizmit të bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve shtetërore përgjegjëse për referimin e rasteve të fëmijëve në rrezik, si dhe mënyrën e procedimit të tij"; Vendimit Nr.266, datë 12.04.2012, të Këshillit të Ministrave "Për bashkërendimin e mekanizmave në nivel qendror dhe vendor për çështjet e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve",

Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (MMSR), Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), dhe Ministria e Arsimit dhe e Sporteve, këtu përmendur si "Palët", bien dakord për sa më poshtë vijon:

Neni 1 Objekti i Marrëveshjes

Përcaktimi i qartë i detyrave dhe përgjegjësisë të Palëve për zbatimin e Planit të Veprimit për identifikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge, pjesë integrale e kësaj marrëveshjeje.

Neni 2 Qëllimi i Marrëveshjes

Bashkëpunimi efektiv i Palëve për identifikimin proaktiv dhe mbrojtjen e fëmijëve në situatë rrugë nga të gjitha format e abuzimit, shfrytëzimit dhe neglizhencës, përmes një ndërhyrjeje të koordinuar dhe ndër-sektoriale

Neni 4 Përgjegjësitë e Palëve

4.1 Përgjegjësitë e MMSR

4.1.1 MMSR nëpërmjet Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve:

- Bashkërendon punën me institucionet shtetërore dhe jo shtetërore për zbatimin e Planit të Veprimit për identifikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge;
- Organizon takime periodike të Task Forcës, me përfaqësues të institucioneve zbatuese të Marrëveshjes dhe Planit të Veprimit;
- Përditëson Planin e Veprimit dhe monitoron zbatimin e tij;
- Përgatit udhëzime metodologjike për profesionistët mbi punën me fëmijët në situatë rruge, dhe ua propozon Ministrive përkatëse për miratim dhe zbatim;
- Mbështet me trajnime dhe ngritje kapacitetesh profesionistët e përfshirë, në bashkëpunim me aktorët publikë dhe jo publikë;

- Përgatit raporte periodike mbi ecurinë dhe zbatimin e planit dhe informon institucionet palë dhe të tjera të përfshira në zbatim të Planit të Veprimit.

4.1.2 MMSR nëpërmjet Shërbimit Social Shtetëror (ShSSH):

- Vë në dispozicion strukturat e Shërbimit Social Shtetëror dhe Drejtorive të Shërbimit Social Rajonal për drejtimin, koordinimin dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë së skuadrave të terrenit;
- Vë në dispozicion paketën e shërbimeve sociale për menaxhimin e rasteve të referuara në kuadër të kësaj Marrëveshjeje, të zbatuar drejtpërdrejtë nga ShSSH;
- Siguron ndërhyrjen emergjente për rastet në rrezik të lartë të fëmijëve të evidentuar në koordinim të ngushtë me pushtetin vendor dhe organizatat që ofrojnë shërbime sociale emergjente;
- Bashkëpunon me Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijës (NJMF) në bashki/komunë, të cilat në bazë të Ligjit Nr.10347, kanë detyrë të bëjnë identifikimin dhe të bashkërendojnë në mënyrë multidisiplinare, mbrojtjen, referimin dhe analizën e rasteve në territorin e bashkisë/komunës;
- Merr pjesë në takimet për bashkërendimin e punës së Task Forcës.

4.1.3 MMSR nëpërmjet Shërbimit Kombëtar të Punësimit:

- Shqyrton me përparësi rastet e referuara në kuadër të kësaj Marrëveshjeje;
- Vë në dispozicion shërbimet lidhur me punësimin dhe arsimin profesional për rastet e referuara në kuadër të kësaj Marrëveshjeje;
- Këshillon, lehtëson dhe mbështet krijimin e marrëdhënieve të punës;
- Merr pjesë në takimet për bashkërendimin e punës së Task Forcës.

4.2 Përgjegjësitë e MPB

4.2.1 MPB nëpërmjet Zyrës së Koordinatorit Kombëtar Antitrafik:

- Nëpërmjet Autoritetit Përgjegjës, bashkërendon punën për rastet e dyshuara dhe të evidentuara të trafikimit sipas Procedurave Standarde të Veprimit;
- Bashkërendon punën me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe institucionet e tjera në varësi të MBP-së për rastet e fëmijëve të paregjistruar;
- Shkëmben informacion me Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve për rastet e trafikimit duke respektuar detyrimet e ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale";
- Merr pjesë në takimet për bashkërendimin e punës së Task Forcës.

4.2.2 MPB nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit (DPPSH)

- Vë në dispozicion strukturat e saj të varësisë për zbatimin e Planit të Veprimit;
- Vë në dispozicion të skuadrave të terrenit punonjës policie të strukturave vendore të policisë, në rastet kur kjo gjë është e domosdoshme për trajtimin e rasteve të fëmijëve në situatë rruge;
- Ofron asistencë dhe këshillim nëpërmjet specialistëve të Sektorit për të Miturit dhe Dhunës në Familje në DPPSH, në rastet kur nga ana e skuadrave të terrenit dhe strukturave vendore të policisë hasen vështirësi në trajtimin e rasteve të evidentuara;
- Harton udhëzime për strukturat vendore të Policisë së Shtetit në lidhje me mënyrën e evidentimit, trajtimit apo referimit të rasteve të fëmijëve në situatë rruge të evidentuara gjatë punës rutinë;

- Referon tek skuadrat e terrenit çdo rast të fëmijëve në situatë rruge të evidentuar apo identifikuar nëpërmjet linjës telefonike falas 116 006 dhe 129;
- Identifikon dhe heton në mënyrë proaktive rastet e shfrytëzimit të fëmijëve në situatë rruge;
- Në zbatim të legjislacionit në fuqi, merr masat e nevojshme për trajtimin e rasteve të identifikuara;
- Merr pjesë në takimet për bashkërendimin e punës së Task Forcës.

4.3 Përgjegjësitë e MAS

4.3.1 MAS përmes Drejtorive Arsimore Rajonale dhe Zyrave Arsimore

- Në zbatim të legjislacionit në fuqi merr masat për regjistrimin në shkollën apo kopshtin më të afërt të fëmijëve në situatë rruge të referuar nga NJMF;
- Vë në dispozicion strukturat e varësisë së DAR/ZA si shërbimin psikologjik dhe social në shkolla dhe drejtoritë e shkollave për asistimin e rasteve të fëmijëve në situatë rruge që janë regjistruar në shkollë dhe për monitorimin e frekuentimit të shkollës;
- DAR dhe ZA dhe shkollat bashkëpunojnë me NJMF dhe organizatat fitimprurëse që veprojnë në fushën e arsimit dhe të mbrojtjes së fëmijëve për rastet e braktisjes rikthimin në shkollë të fëmijëve në situatë rruge;
- Zbaton dhe monitoron të gjitha masat e përcaktuara për sigurimin e teksteve dhe mjeteve shkollore për fëmijët në situatë rruge që janë regjistruar dhe ndjekin arsimin e detyruar në përmbushje të udhëzimit të MAS;
- Merr pjesë në takimet për bashkërendimin e punës së Task Forcës.

Neni 5

Kohëzgjatja e Marrëveshjes

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi me nënshkrimin nga Palët dhe mbetet e vlefshme deri në një afat të pacaktuar.

Neni 6

Përfundimi i Marrëveshjes

Marrëveshja mund të përfundojë nga secila Palë me informimin me shkrim 30 ditë përpara të Palës tjetër.

Neni 7

Ndryshimi i Marrëveshjes

Marrëveshja mund të ndryshohet me shkrim në çdo kohë me aprovimin e përbashkët të Palëve.

Neni 8

Dispozita Përfundimtare

Veprimtaritë e kryera mbi bazën e Marrëveshjes së Bashkëpunimit “Për identifikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge”, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (nr.4776 prot, datë 17.09.2014) dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme (nr.8187 prot, datë 10.10.2014), njihen nga palët dhe konsiderohen të ligjshme.

Marrëveshja e Bashkëpunimit “Për identifikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge”, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (nr.4776 prot, datë 17.09.2014) dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme (nr.8187 prot, datë 10.10.2014), ndërpret fuqinë e saj ligjore, në momentin e hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshje.

Kjo Marrëveshje është përgatitur në 3 kopje origjinale, nga një kopje origjinale për secilën palë. Marrëveshja hynë në fuqi pas nënshkrimit nga palët.

PËR
Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe
Rinisë:

Z. Blendi KLOSI

Data e nënshkrimit



PËR
Ministrinë e Punëve të Brendshme:
Z. Saimir LAHIRI

Data e nënshkrimit



PËR
Ministrinë e Arsimit dhe Sportit
Znj. Lindita NIKOLLA

Data e nënshkrimit

